

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, i përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.K. me vendbanim në P., rr:”...”, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.142/2018 të dt.10.10.2018 mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.03.12.2018 në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci dhe të akuzuarit, të njëjtën datë në prezencë të palëve mori, publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R.K., nga i ati D. dhe e ëma N., e vajzërisë K., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar-baba i 2 fëmijëve, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, sipas evidencës penale të kësaj gjykate ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 20.03.2018 rreth orës 13:00 në P., i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit Marihuanë në atë mënyrë që pas një kontrolli nga ana e pjesëtarëve të PK-së në xhep i janë gjetur 6 qese të vogla me marihuanë, me peshë prej 14.1 gram ndërsa gjatë bastisjes në shtëpinë e tij që gjendet në rrugën “...” në P., të pandehurit i janë gjetur dhe sekuestruar 51.9 gram,-

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 62, 69, 73, 74, 275 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind/€uro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale- të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet/€uro) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë/€uro) të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7 dhe nenit 69 par.1 të KPRK, të akuzuarit gjithashtu i shqipton këtë:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen 4 qese të paketuara dhe një sasi e pa paketuar me substancë-Marihuanë në peshë prej 33.5 gram, sasi tjetër me substancë-Marihuanë në peshë prej 15.2 gram, një pako e cigareve me 3 cigare me substancë-Marihuanë në peshë prej 2.8 gram dhe një sasi me substancë-Marihuanë në peshë prej 0.4 gram të cilat përkohësisht janë sekuestruar nga Drejtoria e hetimit të trafikimit me narkotikë në Prishtinë, me numër të rastit 2018-AF-0215 të dt.08.05.2018.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.142/2018 të dt.10.10.2018 kundër të akuzuarit R.K. me vendbanim në P., rr:"...", për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 03.12.2018, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoi fajësinë, marihuana ka qenë e imja dhe nuk e kam pasur për ta shitur, e kam përdorur kapak mirëpo prej atij momenti nuk e kam përdorur më dhe lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë sepse ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, jam i pa punë, i martuar-baba i 2 fëmijëve, kam gabuar më vjen shumë keq.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase ky pranim është bërë konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, me vullnetin e plotë dhe pa kurfarë presioni nga ana e të pandehurit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet i akuzuari, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit R.K. përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata mori parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat e parapara në nenin 73 të KPRK-së për shqiptimin e dënimit më të butë apo më të ashpër e sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivin për kryerjen e veprës penale, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, sjellja e mëparshme e kryesit, deklarimi i tij rreth fajësisë, rrethanat personale, qëndrimi pas kryerjes së veprës prandaj konsideron se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë sipas aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë me shenjen P.nr.314/2016 e dt.13.03.2017 shkallën e lartë të përgjegjësisë penale pasi që i njëjti veprën e ka kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është shoqëria në përgjithësi si dhe rrezikimi dhe dëmtimi i shëndetit të njerëzve e posaqërisht shëndetit të rinjëve meqenëse në ditët e sotme përdorimi i substancave narkotike gjithnjë e më shumë po merr përmasa shumë të larta dhe numri i përdoruesve të drogës është një trend në rritje, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm, prandaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues-konfiskimin e substancave narkotike të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7, nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.657/2018 me dt.03.12.2018

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.